



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr. 05/2017

**Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të
sistemit të shpërndarjes
(Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së)**

16 Mars 2017

Përmbajtja

KREU I	KUSHTET E PËRGJITHSHME	4
	Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi	4
	Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimet	4
Kreu II	RREGULLIMI I TË HYRAVE TË OSSH-së	9
	Neni 3 Parimet e përgjithshme	9
	Neni 4 Shqyrtimet e vlerave hyrëse	9
	Neni 5 Shqyrtimet periodike dhe periudhat rregullative	10
	Neni 6 Përshtatjet e rregullta	10
	Neni 7 Shqyrtimet e jashtëzakonshme	11
KREU III	TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	12
	Neni 8 Parimet themelore	12
	Neni 9 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes	13
	Neni 10 Zhvlerësimi i lejuar	13
	Neni 11 Kthimi i lejuar në kapital	13
	Neni 12 Kostot e lejuara të humbjeve	14
	Neni 13 Kostot e taksës së licencës	15
	Neni 14 Kostot e përjashtuara	15
	Neni 15 Zbutja e të hyrave të lejuara	15
KREU IV	TARIFAT PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES	17
	Neni 16 Parimet e përgjithshme	17
	Neni 17 Procedura për aprovimin e tarifave për SHSSH	17
KREU V	TAKSAT PËR KYÇJE	18
	Neni 18 Parimet e përgjithshme	18
	Neni 19 Procedura për aprovimin e taksave për kyçje	19
KREU VI	DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	20
	Neni 20 Interpretimi	20
	Neni 21 Ndryshimi	20
	Neni 22 Shfuqizimi	20
	Neni 23 Hyrja në fuqi	20
Shtojca 1	LLOGARITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMALE	21
Shtojca 2	VLERAT HYRËSE	26
Shtojca 3	BAZA E ASETIVE TË RREGULLUARA	27
Shtojca 4	MESATARJA E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT	30
Shtojca 5	SHËRBIMET E PËRJASHTUARA	32
Shtojca 6	PROCESI I SHQYRTIMIT PERIODIK	34

Shtojca 7	PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA	36
Shtojca 8	PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM	377
Shtojca 9	NGJARJA E JASHTËZAKONSHME	39
Shtojca 10	NGJARJET E FORCËS MADHORE	400

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-84, nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, nenin 15, paragrafin 1, nënparagrafi 1.5, nenin 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nënparagrafi 1.2 dhe nenin 47, paragrafi 1, në seancën e mbajtur me 16.03.2017, miratoi:

Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së)

KREU I KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Kjo rregull përcakton:
 - 1.1 Bazën për vlerësimin e të hyrave të lejuara maksimale që operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) mund të përfitojë në një vit relevant, në mënyrë që OSSH të mbulojë kostot e arsyeshme të zhvillimit, operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes në mënyrë që ai të vihet në dispozicion të përdoruesve të sistemit në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.2 Procesin sipas të cilit të hyrat e lejuara maksimale do të shqyrtohen dhe do të ripërcaktohen periodikisht dhe azhurnimet e rregullta vjetore;
 - 1.3 Procesin sipas të cilit caktohen tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes (“Tarifat SHSSH”), të cilat përdoren për të mbuluar të hyrat e lejuara maksimale dhe taksat për kyçje të aplikuara nga OSSH; dhe
 - 1.4 Procesin sipas të cilit përcaktohen taksat për kyçje dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes (SHSSH), prej të cilave do të mblidhen të hyrat maksimale të lejuara.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Të hyrat e rregulluara aktuale** - të hyrat e mbuluara nga OSSH përmes tarifave për kryerjen e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes si dhe të gjitha të hyrat e tjera të përcaktuara nga rregullatori e të matura në baza aktuale;
 - 1.2 **Plan i aprovuar i investimit** - programi i projekteve kapitale për periudhën rregullative siç aprovohet nga rregullatori në kuadër të shqyrtimit periodik;

- 1.3 **Ditë pune** - ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas ligjeve në Kosovë;
- 1.4 **Taksë për kyçje** - taksën e aplikuar nga OSSH për kyçjen e konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes;
- 1.5 **Humbjet në shpërndarje** - totali i energjisë së humbur në sistemin e shpërndarjes të operuar nga OSSH, dhe përbëhen nga:
- (a) humbjet teknike siç përcaktohen nga vlerësimet inxhinierike, dhe;
 - (b) humbjet komerciale, të cilat përfshijnë energjinë në hyrje të sistemit të shpërndarjes minus humbjet teknike dhe minus energjia e faturuar te konsumatorët fundor;
- 1.6 **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose OSSH** - personi fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- 1.7 **Shërbimet e sistemit të shpërndarjes** - shërbimet të cilat i licencuari për OSSH është i autorizuar t'i ofrojë sipas kushteve të licencës për operim të sistemit dhe për shpërndarje, të dhënë nga rregullatori, e që kanë të bëjnë me ofrimin e një sistemi të shpërndarjes të besueshëm, të qëndrueshëm dhe të sigurt për të gjithë personat që do ta përdorin sistemin;
- 1.8 **Sistemi i Shpërndarjes** - kombinim i linjave të energjisë elektrike dhe pajisjeve të energjisë elektrike me tension të mesëm dhe të ulët që shërbejnë për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- 1.9 **Ndërmarrje e energjisë elektrike** - personi fizik apo juridik që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike ose të mirëmbajtjes që ndërlidhen me veprimtaritë e cekura, por nuk përfshinë konsumatorin final;
- 1.10 **Tarifat SHSSH** - tarifat e aplikuara nga OSSH për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes;
- 1.11 **Jetëgjatësia Ekonomike** - shpërndarjen sistematike të shumës së zhvlerësueshme të një aseti gjatë jetës së tij të dobishme të lejuar nga baza e aseteve të rregulluara;
- 1.12 **Faktori i efikasitetit** - caku i reduktimit të kostove i përcaktuar gjatë shqyrtimeve periodike dhe që aplikohet gjatë përshtatjeve të rregullta për të përcaktuar kostot e lejuara të operimit dhe të mirëmbajtjes për OSSH;
- 1.13 **EURIBOR** - normën e ofrimit për depozita të euros nga Federata bankare evropiane për periudhë 12-mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të "Reuters" në ora 11:00 (kohë e matur sipas kohës qendrore evropiane) ose, në rast se "Reuters" nuk

vazhdon ta ofrojë këtë shërbim, cilido shërbim tjetër të cilin Rregullatori e konsideron si të besueshëm;

- 1.14 **Shërbimet e përjashtuara** - shërbimet që ofrohen nga OSSH në kuadër të aktiviteteve të saj të licencuara, kostot e të cilave përjashtohen nga të hyrat e lejuara maksimale dhe të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen me, kryerjen e kyçjeve në sistemin e shpërndarjes apo ofrimin e shërbimeve për palët e treta;
- 1.15 **Ngjarje e Jashtëzakonshme** - ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 9;
- 1.16 **Shqyrtim i Jashtëzakonshëm** - ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7;
- 1.17 **Forcë Madhore** - ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 10;
- 1.18 **Taksa për licencë** - shumën për pagesë sipas Pasqyrës së taksave, që lëshohet nga rregullatori;
- 1.19 **Humbjet e lejuara** - ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 12;
- 1.20 **Faktori i ndarjes së humbjeve** - ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 12;
- 1.21 **Faktori i ndarjes së kursimeve** - ka kuptimin e dhënë në Shtojcën 2;
- 1.22 **Pragu i Materialitetit** - ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
- 1.23 **Të Hyrat e Lejuara Maksimale ose MAR** - të hyrat maksimale siç përcaktohet në Shtojcën 1 të kësaj rregulle, që mund të mbulohen brenda një viti relevant nga OSSH përmes tarifave SHSSH.
- 1.24 **Kërkesa maksimale e sistemit të shpërndarjes** - kërkesa maksimale e energjisë elektrike brenda një viti (në MW) e matur në pikat hyrëse të sistemit të shpërndarjes të OSSH-së;
- 1.25 **E Matur** - çdo sasi e matur e energjisë elektrike, duke përfshirë këtu matjet për energjinë aktive, energjinë reaktive dhe fuqinë, në pajtim me matësin e instaluar sipas Kodit të matjes;
- 1.26 **Vlera Neto e Tanishme** - shuma e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë;
- 1.27 **Faktori Profilizues** - faktori që përcaktohet në shqyrtimet periodike dhe që aplikohet në kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes, zhvlerësimin dhe kthimin në kapital siç sqarohet në Nenin 15;
- 1.28 **Vlerësim i përkohshëm** - ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.29 **Furnizues** - ndërmarrje e energjisë së licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit;
- 1.30 **Furnizim** - shitjen, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te konsumatorët;

- 1.31 **Shqyrtimi Periodik** - shqyrtimi nga rregullatori i të hyrave të lejuara maksimale të OSSH-së për periudhën e ardhshme rregullative;
- 1.32 **Përshtatje e Rregullt** - përshtatje e të hyrave të lejuara maksimale që bëhet në fund të çdo viti relevant;
- 1.33 **Njësitë e rregulluara të faturuara** - sasia totale e njërive të energjisë elektrike që u faturohet konsumatorëve fundor që u furnizohen nga sistemi i shpërndarjes;
- 1.34 **Njësitë e rregulluara të shpërndara** - sasia totale e energjisë elektrike të shpërndarë përmes sistemit të shpërndarjes për konsumatorët fundor brenda një viti relevant, të matur në pikat dalëse të sistemit të shpërndarjes (ose, në rastet kur nuk ka matës, të llogaritura sipas praktikave të njohura inxhinierike);
- 1.35 **Balancimi** - është tërësia e proceseve, nëpërmjet të cilave Operatori i Sistemit të Shpërndarjes operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të përcaktuar të qëndrueshmërisë së tij;
- 1.36 **Zyra e Rregullatorit për Energji** - (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
- 1.37 **Baza e asetëve të rregulluara** - të gjitha asetet e përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve nga subjekti i rregulluar, përveç asetëve plotësisht të zhvleftësuar;
- 1.38 **Periudhë Rregullative** - ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5;
- 1.39 **Vit Relevant** - periudha prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm në mes të përshtatjeve të rregullta;
- 1.40 **Parimet për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes dhe taksave të kyçjes** - parimet që lëshohen nga rregullatori me të cilën duhet të jenë në pajtueshmëri metodologjitë e OSSH-së për përcaktimin e tarifave SHSSH dhe taksave për kyçje;
- 1.41 **Raport mbi ndikimin financiar** - ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
- 1.42 **Shfrytëzim i sistemit** - shfrytëzimi i sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike nga pika hyrëse deri në pikat e furnizimit për konsumatorët fundor;
- 1.43 **Mesatare e Ponderuar e Kostos së Kapitalit** - ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 4;
- 1.44 **Çmimet referente të tregut të energjisë elektrike** - është çmimi mesatar i energjisë elektrike të tregtuara në tregje të energjisë në mënyra të ndryshme dhe periudha të ndryshme;
- 1.45 **Grant kapital** - mbështetje financiare, apo forma tjera të mbështetjes pa kthim të investimeve;

- 1.46 Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.

Neni 3**Parimet e përgjithshme**

- 1 OSSH duhet të propozojë tarifat SHSSH ashtu që brenda çdo viti relevant, të hyrat që parashikon të mbledhë nga këto tarifa të jenë të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale (KREU III) të aprovuara nga rregullatori.
- 2 Të hyrat e lejuara maksimale do të përcaktohen si vijon:
 - 2.1 Të hyrat e lejuara maksimale do të caktohen në shqyrtimet periodike (Neni 5);
 - 2.2 Para përfundimit të çdo viti relevant do të aplikohet përshtatja e rregullt (Neni 6) që përfshin përshtatjet e të hyrave të lejuara maksimale për të marrë parasysh ndryshimet e arsyetuara të kostove, përfshirë edhe kostot që janë jashtë kontrollit të OSSH-së; dhe
 - 2.3 Shqyrtimet e jashtëzakonshme (Neni 7), që përfshijnë përshtatjet në të hyrat e lejuara maksimale si rezultat i ndryshimeve materiale të kostove të shkaktuara nga një ngjarje e jashtëzakonshme.

Neni 4**Shqyrtimet e vlerave hyrëse**

- 1 Vlerat hyrëse përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike, këto vlera përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të OSSH-së.
- 2 Shqyrtimet e vlerave hyrëse do të iniciohen nga rregullatori kurdo që rrethanat e ndryshuara kërkojnë iniciimin e një shqyrtimi të tillë. Ndryshimet në vlerat hyrëse duhet të bëhen vetëm në atë masë që këto ndryshime të jenë të arsyeshme, të justifikuara dhe të caktuara me kujdes.
- 3 OSSH mund t'i propozojë rregullatorit e shqyrtimin të vlerave hyrëse. Rregullatori do t'i përgjigjet kërkesës së tillë me një shkresë që paraqet arsyetimet për vendimin e ZRRE-së për të filluar apo për të mos filluar shqyrtimin.
- 4 Procedura për mbarëvajtjen e shqyrtimeve të vlerave hyrëse është dhënë në Shtojcën 2.

Neni 5

Shqyrtimet periodike dhe periudhat rregullative

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale për OSSH-në për periudhën rregullative do të përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike.
- 2 Shqyrtimet periodike do të inicohen para çdo periudhe rregullative.
- 3 Secila periudhë rregullative do të jetë 5-vjeçare, përveç:
 - 3.1 Në rast të pajtimit reciprok në mes të OSSH-së dhe rregullatorit, periudha periodike mund të shkurtohet apo të zgjatet;
- 4 Formulatat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale gjatë shqyrtimeve periodike janë dhënë në Shtojcën 1.
- 5 Procesi për kryerjen e shqyrtimeve periodike është dhënë në Shtojcën 6.

Neni 6

Përshtatjet e rregullta

- 1 Gjatë përshtatjeve të rregullta do të llogariten ndryshimet e lejuara të të hyrave të lejuara maksimale.
- 2 Përshtatjet e rregullta do të bëhen para çdo viti relevant të ardhshëm.
- 3 Ndryshimi i të hyrave të lejuara maksimale gjatë çdo përshtatjeje të rregullt do të llogaritet duke u bazuar në:
 - 3.1 Indeksimin e kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes me përmirësimet e pritura përmes faktorit të efikasitetit;
 - 3.2 Indeksimin e kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (pas aplikimit të faktorit të efikasitetit), zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar në kapital me inflacionin;
 - 3.3 Azhurnimi i parashikimit të kostos së lejuar të humbjeve dhe taksës së licencës;
 - 3.4 Nën-mbulimi apo mbi-mbulimi i kostove të lejuara të humbjeve në vitin aktual (tashmë të përfunduar) relevant, që mund të vijnë si pasojë e ndryshimeve të volumeve të energjisë elektrike të parashikuar dhe asaj të shpërndarë dhe çmimeve referente të tregut energjisë elektrike, subjekt i ndarjes së nën apo mbi-mbulimit të tillë në mes të OSSH-së dhe shfrytëzuesve të sistemit të shpërndarjes; dhe
 - 3.5 Nën-mbulimi apo mbi-mbulimi i të hyrave të lejuara maksimale në vitin aktual (tashmë të përfunduar) relevant, që mund të vijnë si pasojë e ndryshimeve të energjisë elektrike të parashikuar dhe asaj të shpërndarë në rrjetin e saj dhe/apo ndryshimeve në mes të kërkesës maksimale të parashikuar dhe asaj të realizuar dhe/apo ndryshimeve në mes të numrit të parashikuar dhe aktual të konsumatorëve.

- 4 Kurdo që rregullatori vëren (vlerëson) se i licencuari nuk ka realizuar kostot me qëllim të kursimit dhe rritjes së profitit (në veçanti shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes) duke mos përmirësuar kualitetin e shërbimit dhe performancës në nivelin e kërkuar sipas standardeve, rregullatori mund të bëjë përshtatjet e këtyre kostove gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale gjatë përshtatjeve të rregullta apo në periudhën e ardhshme rregullative.
- 5 Në rastin kur i licencuari arrin të realizojë të njëjtat objektiva (të kualitetit të shërbimit dhe performancës) me kosto më të ulta si rezultat i efikasitetit dhe performancës së tij, rregullatori do të lejojë që i licencuari të mbaj ndryshimin e këtyre kostove si nxitje në përmirësimin e performancës. Nxitjet për kursimet e tilla bëhen duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve.
- 6 Në rastin e tejkalimeve të shpenzimeve mbi nivelin e lejuar, ndryshimi i kostove të tilla do të jetë barrë e OSSH-së, përveç të shpenzimeve të cilat janë jashtë kontrollit të saj.
- 7 Në rastin kur ka ndryshime ndërmjet investimeve kapitale të lejuara dhe realizuara gjatë cilitdo vit relevant, rregullatori mund të bëjë përshtatjet e kostove të zhvlerësimit dhe kthimit të cilat derivohen nga investimet kapitale. Përshtatje e këtyre kostove mund të bëhen gjatë procesit të përshtatjeve të rregullta apo në periudhën e ardhshme rregullative.
- 8 Formulatat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale gjatë përshtatjeve të rregullta jepet në Shtojcën 1, ndërsa procesi për kryerjen e përshtatjeve të rregullta jepet në Shtojcën 7.

Neni 7

Shqyrtimet e jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga ngjarjet e jashtëzakonshme, siç përkufizohen në Shtojcën 9.
- 2 Gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale për pjesën e mbetur të periudhës aktuale rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të bëhet përshtatja e të hyrave të lejuara maksimale. Pragu i materialitetit duhet të jetë mbi 5 % i të hyrave, përveç nëse vendoset ndryshe gjatë shqyrtimeve periodike mbi bazë të pajtimit reciprok të OSSH-së dhe rregullatorit.
- 3 Llogaritja e ndikimit në të hyrat e lejuara maksimale dhe e përshtatjes së jashtëzakonshme nuk duhet të marrë parasysh faktorët të cilët nuk ndikohen drejtpërsëdrejti nga ngjarja e jashtëzakonshme.
- 4 Rregullatori do të marrë parasysh gjithashtu ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë praguin e materialitetit) në shqyrtimet e ardhshme periodike.
- 5 Procesi për kryerjen e shqyrtimeve të jashtëzakonshme është dhënë në Shtojcën 8.

KREU III TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE

Neni 8

Parimet themelore

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale do të caktohen në atë nivel që do t'i mundësojë OSSH-së të mbulojë kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve të sistemit të shpërndarjes deri në masën që këto kosto të jenë të arsyetuara dhe të vlerësuara me kujdes.
- 2 Kostot e arsyeshme të OSSH-së përfshijnë:
 - 2.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (Neni 9), të cilat do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin dhe faktorin e efikasitetit gjatë përshtatjeve të rregullta;
 - 2.2 Zhvlerësimin e lejuar (Neni 10), i cili do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin gjatë përshtatjeve të rregullta;
 - 2.3 Kthimin e lejuar në kapital (Neni 11), i cili do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin gjatë përshtatjeve të rregullta;
 - 2.4 Koston e lejuar të humbjeve (Neni 12), që do të bartet bazuar në nivelin e humbjeve të lejuara dhe në faktorin e ndarjes së humbjeve gjatë përshtatjeve të rregullta;
 - 2.5 Taksën e licencave (Neni 13), që do të bartet në mënyrë të plotë gjatë përshtatjeve të rregullta; dhe
 - 2.6 Kostot e shërbimeve publike, taksat, detyrimet dhe shpenzimet e imponuara mbi OSSH-në në një mënyrë ligjore që nuk mbulohen përmes ndonjë mekanizmi tjetër.
- 3 Gjatë përcaktimit të kostove të lejuara, rregullatori do t'u referohet, në mes tjerash, edhe:
 - 3.1 Informatave ekzistuese të periudhave të kaluara për vëllimin, koston dhe kualitetin e shërbimeve të OSSH-së;
 - 3.2 Parashikimit rreth vëllimit, kostove dhe kualitetit të shërbimeve të OSSH-së;
 - 3.3 Krahasimeve me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës; dhe
 - 3.4 Krahasimeve me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës.

Neni 9

Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes

- 1 Me dorëzimin e vlerësimeve të kostove operative dhe mirëmbajtjes të OSSH-së të cilat kërkohet të mbulohen përmes të hyrave të lejuara maksimale për periudhën rregullatore vijuese, OSSH do të kërkojë të mbulojë vetëm atë pjesë të atyre kostove që mund t'i atribuohen licencës së OSSH-së.
- 2 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes duhet të përfshijnë vetëm ndonjë komponentë apo element të kostove të korporatës (të ndonjë kompanie amë apo kompanie degë) që mund t'i atribuohet në mënyrë të arsyeshme bartësit të licencës së OSSH-së duke përdorur praktika të kontabilitetit.
- 3 Në çdo përshtatje të rregullt faktori i efikasitetit dhe faktori ndarës i kursimeve do të aplikohen në kostot operative dhe të mirëmbajtjes sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.
- 4 Rregullatori duhet ta caktojë faktorin e efikasitetit gjatë shqyrtimeve periodike mbi bazë të përmirësimit vjetor të efikasitetit në kostot operative dhe të mirëmbajtjes së OSSH-së që në mënyrë të arsyeshme mund të priten.
- 5 Gjatë caktimit të faktorit të efikasitetit, rregullatori duhet t'u referohet, por nuk kufizohet apo limitohet në faktorët e specifikuar në paragrafin 3 të neni 9.

Neni 10

Zhvlerësimi i lejuar

- 1 Kostot e lejuara të zhvlerësimit do të llogariten në mënyrë lineare si funksion i jetëgjatësisë ekonomike apo teknike të aseteve dhe bazës së aseteve të rregulluara për kategori të ndryshme të aseteve, siç përshkruhet në Shtojcën 2.
- 2 OSSH-së nuk do ti lejohet të mbulojë kostot e zhvlerësimit për asetet e financuara nga grantet kapitale dhe kontributet e konsumatorëve (përveç aseteve të përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara në vitin 2012).

Neni 11

Kthimi i lejuar në kapital

- 1 Kthimi i lejuar në kostot e kapitalit do të llogaritet si funksion i bazës së aseteve të rregulluara dhe mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit, siç përshkruhet në Shtojcën 3 dhe Shtojcën 4.
- 2 Kthimi i lejuar në kapital do të llogaritet bazuar në vlerën e bazës së aseteve të rregulluara në çdo vit relevant (si mesatare e vlerave fillestare dhe përfundimtare të bazës së aseteve të rregulluara).
- 3 OSSH nuk do të fitojë kthim të lejuar për asetet e financuara nga grantet kapitale dhe kontributet e konsumatorëve.

Neni 12

Kostot e lejuara të humbjeve

- 1 Kostoja e lejuar e humbjeve do të jetë kostoja e parashikuar e humbjeve që do të mbulohet nga OSSH-ja për të kompensuar humbjet në sistemin e shpërndarjes dhe do të llogaritet duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike.
- 2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes janë pjesëmarrës në treg vetëm për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancimit; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jodiskriminimit.
- 3 Të hyrat e lejuara maksimale do të përshtaten për ndryshimet në koston e lejuar të humbjeve, shpërndarjes gjatë përshtatjeve të rregullta sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1. Kjo përshtatje do të:
 - 3.1 Kthejë nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove të lejuara të humbjeve gjatë vitit relevant, duke marrë parasysh nivelin e lejuar të humbjeve, vëllimin e realizuar të hyrjes së energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes sipas çmimit aktual të arsyeshëm siç përcaktohet nga tregu konkurses për blerjen e humbjeve;
 - 3.2 Ndajë ndryshimin në mes të kostove të lejuara të humbjeve dhe kostove të realizuara të humbjeve gjatë një viti relevant, bazuar në faktorin ndarës të humbjeve që caktohet në shqyrtimet periodike; dhe
 - 3.3 Azhurnojë koston e parashikuar të lejuar të humbjeve për vitin relevant vijues, bazuar në parashikimin e kostove sipas çmimit referent në tregun e energjisë elektrike që përdoret për kalkulimin e kostos së humbjeve.
- 4 Gjatë përcaktimit të nivelit të lejuar të humbjeve, rregullatori do të marrë parasysh:
 - 4.1 Analizën e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes në baza vjetore, duke përfshirë vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike dhe, zhvillimin në zbatimin e masave për reduktimin e humbjeve;
 - 4.2 Përgatitja brenda vitit aktual, e planit vjetor të humbjeve të shpërndarjes për vitin vijues dhe dorëzimi për miratim te Rregullatori. Plani vjetor i humbjeve përfshinë vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike;
 - 4.3 Uljet e pritshme të humbjeve gjatë periudhës rregullative që mund të ndodhin si pasojë e planit të aprovuar të investimit; dhe
 - 4.4 Nivelin e humbjeve të shpërndarjes në sisteme të krahasueshme të shpërndarjes në shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës.

- 5 Niveli i lejuar i humbjeve dhe faktori i ndarjes së humbjeve duhet të jetë i mjaftueshëm që të nxisë OSSH-në të reduktojë humbjet në shpërndarje, por të mos vendosur kosto mbi OSSH-në në atë mënyrë që të kërcënohet pozita e saj financiare.
- 6 Faktori i ndarjes së humbjeve në normë përqindjeje përcakton se çfarë pjese të tepricës ose mungesës së humbjeve të lejuara mbahet nga OSSH.
- 7 Metodologjia e përdorur për matjen e nivelit të humbjeve të realizuara në shpërndarje mund të ndryshohet në bazë të një pajtimi të përbashkët në mes të rregullatorit dhe OSSH-së. Në këto raste, niveli i lejuar i humbjeve do të përshtatet që të jetë në përputhje me metodologjinë e ndryshuar për ta mbajtur nivelin e uljeve të humbjeve të pritshme gjatë periudhës rregullative (të shprehur në pikë përqindjeje) të pandryshuar.

Neni 13

Kostot e taksës së licencës

Rregullatori lejon që OSSH të mbulojë kostot e licenesimit.

Neni 14

Kostot e përjashtuara

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale nuk duhet të mbulojnë kostot për kryerjen e ndonjë shërbimi (duke përfshirë këtu shërbimet rreth linjave elektrike apo stabilimenteve elektrike) që caktohet të jetë shërbim i përjashtuar sipas Shtojcës 5, duke përfshirë:
 - 1.1 Shërbime nga të cilat përfiton në mënyrë të veçantë ndonjë palë e tretë që e kërkon shërbimin; dhe
 - 1.2 Mbulohet nga tarifat apo taksat tjera dhe jo nga tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes.
- 2 Kostoja e kryerjes së shërbimeve të përjashtuara do të mbulohet nga OSSH në pajtim me Shtojcën 5.
- 3 Në rastin kur Rregullatori vlerëson se OSSH nuk mund të bëjë parashikimin e kostove të përjashtuara për shërbimet e përjashtuara gjatë shqyrtimit tarifor, atëherë rregullatori do të kërkojë nga OSSH të hyrat e realizuara nga ofrimi i shërbimeve të përjashtuara dhe ato do të zbriten gjatë përcakimit të të hyrave për OSSH-në në vitin vijues.

Neni 15

Zbutja e të hyrave të lejuara

- 1 Gjatë shqyrtimeve periodike, rregullatori mund të zbusë mbulimin e zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar në kapital, kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes në atë mënyrë që ato të jenë konstante në secilin vit relevant të periudhës rregullative. Kjo zbutje do të arrihet duke siguruar që vlerat neto të tanishme të këtyre kostove të zbutur apo të pazbutur (gjatë

periudhës rregullative) të jenë të barabarta, duke përdorur mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit si normë diskontimi.

- 2 Gjatë shqyrtimeve periodike, rregullatori gjithashtu mund të përshtatë profilin e të hyrave të lejuara maksimale gjatë periudhës rregullative, në mënyrë që të minimizojë ndryshimet të konsiderueshme në mes të vitit të fundit të periudhës së tanishme rregullative dhe vitit të parë të periudhës së ardhshme rregullative. Rregullatori do t'i kushtojë vëmendje të veçantë ndikimit të çfarëdo profilizimi që do të ketë mbi rrjedhën e parasë së OSSH-së dhe aftësinë e saj për të ofruar shërbime të sistemit të shpërndarjes.
- 3 Profilizim shtesë do të bëhet duke aplikuar faktorin profilizues, i cili mund të variojë për secilin vit relevant të periudhës rregullative. Me caktimin e faktorit profilizues gjatë shqyrtimeve periodike, rregullatori do të sigurojë që vlera neto e tanishme e të hyrave të parashikuara të lejuara maksimale (gjatë periudhës rregullative) të mbetet e pandryshuar, duke përdorur mesataren e kostos së ponderuar të kapitalit si normë diskontimi.

KREU IV TARIFAT PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

(TARIFAT E SHSSH)

Neni 16

Parimet e përgjithshme

- 1 OSSH do t'i propozojë tarifat SHSSH për aprovim nga rregullatori në mënyrë që:
 - 1.1 OSSH të mbulojë të hyrat e lejuara që nuk mbulohen nga ngarkesat e tjera apo nga shërbimet e përjashtuara; dhe
 - 1.2 Tarifat e SHSSH të jenë në pajtim me metodologjinë e zhvilluar nga OSSH-ja dhe të aprovuar nga rregullatori. Kjo metodologji duhet të jetë në pajtim me parimet e tarifave të shpërndarjes të nxjerrë nga rregullatori.

Neni 17

Procedura për aprovimin e tarifave për SHSSH

- 1 OSSH do t'i dorëzojë për aprovim rregullatorit metodologjinë për tarifat e SHSSH për amendamentet pasuese të kësaj metodologjie së paku 15 ditë pune para datës së propozuar për hyrjen e tyre në fuqi.
- 2 Metodologjitë apo amendamentimet nuk do të jenë efektive pa aprovimin e rregullatorit.
- 3 OSSH do të ketë të drejtë të propozojë tarifat SHSSH për aprovim nga rregullatori sipas kërkesave të Nenit 16.

KREU V TAKSAT PËR KYÇJE

Neni 18

Parimet e përgjithshme

- 1 OSSH do t'i propozojë taksat për kyçje për aprovim nga rregullatori në mënyrë që:
 - 1.1 OSSH të mbulojë kostot e kyçjeve që nuk mbulohen nga tarifat e tjera; dhe
 - 1.2 Taksat për kyçje të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OSSH dhe të aprovuar nga rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me parimet e taksave për kyçje në sistemin e shpërndarjes të nxjerrë nga rregullatori.
- 2 Kostot e kyçjes do të përfshijnë:
 - 2.1 Koston e punëve që kanë të bëjnë me instalimin e stabilimenteve elektrike, linjave, matësve si dhe pajisjeve të tjera që shfrytëzohen për ndërtimin apo modifikimin e një kyçjeje të ndonjë konsumatori përderisa këto kosto nuk mbulohen nga tarifat SHSSH;
 - 2.2 Koston e mënjanimit të stabilimenteve elektrike, linjave, matësve apo pajisjeve të tjera për shkyçjen e një pike të energjisë elektrike apo ndonjë konsumatori nga sistemi i shpërndarjes që përndryshe nuk mbulohen nga tarifat SHSSH;
 - 2.3 Normën e arsyeshme të kthimit të kapitalit që përfaqësohet nga këto kosto që përndryshe nuk mbulohen nga tarifat SHSSH; dhe
 - 2.4 Kostot e mirëmbajtjes së stabilimenteve elektrike, linjave, matësve dhe pajisjeve të tjera që përndryshe nuk mbulohen nga tarifat SHSSH.
- 3 Të hyrat nga taksat për kyçje përfshihen në të hyrat nga shërbimet e përjashtuara siç përkufizohen në Shtojcën 5.
- 4 Kufiri në mes të atyre kostove që mbulohen nga taksat e kyçjes, kostove që mbulohen nga tarifat SHSSH dhe kostove që mbulohen nga ngarkesat e tjera do të definohet në metodologjinë për përcaktimin e taksave të kyçjes.

Neni 19

Procedura për aprovimin e taksave për kyçje

- 1 OSSH do t'i dorëzojë për aprovim rregullatorit metodologjinë e taksave për kyçje dhe amendamentimet pasuese së paku 15 ditë pune para datës së propozuar të hyrjes së tyre në fuqi.
- 2 Asnjë metodologji apo amendamentim i metodologjisë nuk do të jetë efektive pa aprovimin e rregullatorit.
- 3 OSSH ka të drejtë të propozojë taksat për kyçje për aprovim nga rregullatori sipas kërkesave të Nenit 18.
- 4 Palët të cilat kyçen në sistemin e shpërndarjes kanë të drejtë të paraqesin ankesë mbi taksat për kyçje te rregullatori, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës.

KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 20 Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 21 Ndryshimi

- 1 ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
- 2 Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 22 Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon rregullën e mëparshme të titulluar : *“Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes”* (15 dhjetor 2011) e nxjerrë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185.

Neni 23 Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji :

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

SHTOJCA 1 LLOGARITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMALE

- 1 Kjo shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale për OSSH-në. Kjo shtojcë plotëson parimet e dhëna në pjesën kryesore të rregullës.
- 2 Të hyrat e lejuara maksimale (MAR_t) do të llogariten gjatë shqyrtimeve periodike dhe përshtatjeve të rregullta sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LSSC_t + LICC_t - NTFR_t + ADJ_t + KREV_t$$

Ku janë:

MAR_t	<i>Të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant t ("Maximum Allowed Revenues in Relevant Year t")</i>
$OPMC_t$	<i>Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t ("Operating and maintenance costs in Relevant Year t")</i>
$DEPC_t$	<i>Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t ("Allowed depreciation in Relevant Year t")</i>
$RTNC_t$	<i>Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant t ("Allowed return on capital in Relevant Year t")</i>
$LSSC_t$	<i>Koston e lejuar të humbjeve në vitin relevant t ("Allowed cost of losses in Relevant Year t")</i>
$LICC_t$	<i>Taksën e licencës në vitin relevant t ("Licence Fee in Relevant Year t")</i>
$NTFR_t$	<i>Të hyrat jo tarifore në vitin relevant t ("Non-tariff revenues in Relevant Year t")</i>
ADJ_t	<i>Përshtatjet e kostove në vitin relevant t ("Adjustments of cost in Relevant Year t")</i>
$KREV_t$	<i>Faktori korrigjues i të hyrave në vitin relevant t ("Revenue Correction Factor in Relevant Year t")</i>

- 2.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes ($OPMC_t$) do të llogariten gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të formulës në vijim:

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

2.1.1 Përshtatjet e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes (OPEX) duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve bëhen sipas formulës në vijim:

$$OPMC_{Adj} = (OPMC_{ft-1} - OPMC_{ot-1}) * SHF$$

Ku janë:

$OPMC_t$	Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t (“allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t”)
$OPMC_{t-1}$	Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik (“allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t-1, except for Relevant Year 1 when a value determined by the Regulator at the most recent Periodic Review shall be used”)
CPI_{t-1}	Vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, të matur duke përdorur “Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë masë tjetër e inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që lejohet gjatë shqyrtimit periodik (“Actual value of inflation in Relevant Year t-1,”)
E_t	Faktorin e efikasitetit në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“the Efficiency Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews”)
P_t	Faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“Profiling Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews”)
$OPMC_{ft-1}$	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes të parashikuara në vitin relevant t-1 (the forecast cost of operating and maintenance cost in Relevant Year t-1)
$OPMC_{at-1}$	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes të realizuara në vitin relevant t-1 (the actual cost of operating and maintenance cost in Relevant Year t-1)
$OPMC_{Adj}$	Përshtatjet për kostot operative (“Operating and maintenance cost adjustment”)
SHF	Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit (“Sharing Factor applicable to the savings that exceeds Efficiency Factor”)

2.2 Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të kësaj formule:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

2.2.1 Përshtatjet e kostove të zhvlerësimit (DEPC) duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve bëhen sipas formulës në vijim:

$$DEPC_{adj} = (DEPC_{ft-1} - DEPC_{at-1}) * SHF$$

Ku janë:

$DEPC_t$	Zhvlerësimi tjetër i lejuar në vitin relevant t , i cili mund të zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative (“other allowed depreciation in Relevant Year t , which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)
$DEPC_{t-1}$	Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant $t-1$, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative (“allowed depreciation in Relevant Year $t-1$, except for Relevant Year 1 when a value determined by the Regulator at the most recent Periodic Review shall be used, which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)
CPI_{t-1}	Vlera aktuale e inflacionit në vitin relevant $t-1$, matur duke përdorur “Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” publikuar nga Eurostat-i (“the actual value of inflation in Relevant Year $t-1$, measured using the “Harmonised Indices of Consumer Prices (HICPs) – All Items, for the Eurozone” published by Eurostat”)
P_t	Faktori profilizues në vitin relevant t , i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“the Profiling Factor in Relevant Year t , which is set at Periodic Reviews”)
$DEPC_{adj}$	Përshtatjet për kostot e zhvlerësimit (“Depreciation cost adjustment”)
$DEPC_{ft-1}$	Zhvlerësimi i parashikuar në vitin relevant $t-1$ (the forecast of depreciation in Relevant Year $t-1$)
$DEPC_{at-1}$	Zhvlerësimi i realizuar në vitin relevant $t-1$ (the actual depreciation in Relevant Year $t-1$)
SHF	Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit (“Sharing Factor applicable to the savings that exceeds Efficiency Factor”)
2.3	Kthimi i lejuar në kapital ($RTNC_t$) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të kësaj formule:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

2.3.1 Përshtatjet e kostove të kthimit (RTNC) duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve bëhen sipas formulës në vijim:

$$RTNC_{adj} = (RTNC_{ft-1} - RTNC_{at-1}) * SHF$$

Ku janë:

$RTNC_t$	Kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t , i cili mund të zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative (“other allowed return on capital in Relevant Year t , which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)
----------	---

$RTNC_{t-1}$	<i>Kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1, kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative (“allowed return on capital in Relevant Year t-1, except for Relevant Year 1 when a value determined by the Regulator at the most recent Periodic Review shall be used, which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)</i>
CPI_{t-1}	<i>Vlera aktuale e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur “Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” publikuar nga Eurostat-i (“the actual value of inflation in Relevant Year t-1, measured using the “Harmonised Indices of Consumer Prices (HICPs) – All Items, for the Eurozone” published by Eurostat”)</i>
P_t	<i>Faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“Profiling Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews”)</i>
$RTNC_{adj}$	<i>Përshtatjet për kostot e kthimit të lejuar (“Return cost adjustment”)</i>
$RTNC_{ft-1}$	<i>Kthimi i parashikuar në kapital në vitin relevant t-1 (the forecast of return on capital in Relevant Year t-1)</i>
$RTNC_{at-1}$	<i>Kthimi i realizuar në kapital në vitin relevant t-1 (the actual return on capital in Relevant Year t-1)</i>
SHF	<i>Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit (“Sharing Factor applicable to the savings that exceeds Efficiency Factor”)</i>
2.4	<i>Kostoja e lejuar e humbjeve ($LSSC_t$) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të kësaj formule:</i>
	$LSSC_t = LSSA_t * REUE_t * RWMP_t + (LSSCa_{t-1} - LSSCf_{t-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$
	<i>Ku janë:</i>
$LSSC_t$	<i>Kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t (“allowed cost of losses in Relevant Year t”)</i>
$LSSA_t$	<i>Lejesa e humbjeve, e cila është një përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes, në vitin relevant t (“the Loss Allowance, which is a percentage of energy entering the Distribution System, in Relevant Year t”)</i>
$REUE_t$	<i>Njësitë e energjisë (në MWh) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t (“the energy units (in MWh) entering the Distribution System in Relevant Year t”)</i>

$RWMP_t$	<i>Çmimi referent i tregut me shumicë per blerjen e energjisë (në €/MWh) në vitin relevant t ("the referent wholesale market electricity price t (in €/MWh) in Relevant Year t")</i>
$LSSCa_{t-1}$	<i>Kostoja e realizuar e lejuar e humbjeve në vitin relevant t-1 (llogaritur duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve) ("the actual allowed cost of losses in Relevant Year t-1 (calculated using the Loss Allowance")</i>
$LSSCf_{t-1}$	<i>Kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1 (llogaritur duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve) ("the forecast cost of losses in Relevant Year t-1 (calculated using the Loss Allowance")</i>
I_t	<i>Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve vjetore apo periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurta mbi normën e EUROBOR-it ("the interest rate for the Relevant Year t calculated based on EURIBOR plus S%, where S is a value to be determined by the Regulator at Regular or Periodic Reviews and which reflects the premium payable by the licensee for short-term loans above the EURIBOR rate")</i>
$LSAC_{t-1}$	<i>Kostoja e humbjeve të realizuara nga OSSH gjatë blerjes së energjisë si kompensim të energjisë së humbur në rrjetin e shpërndarjes në vitin relevant t-1 (nuk llogaritet duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve) ("cost of losses actually incurred by the DSO in purchasing energy as compensation for energy lost on the Distribution System in Relevant Year t-1 (not calculated using the Loss Allowance")</i>
$LSSF_t$	<i>Faktorin e ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike ("the Loss Sharing Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews")</i>
2.5	Faktori i përshtatjes së të hyrave ($KREV_t$) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta duke përdorur formulën në vijim:
	$KREV_t = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$
	<i>Ku janë:</i>
AAC_{at-1}	<i>Kostot e lejuara aktuale për vitin relevant t-1 ("Actual Allowed Cost as determined in Relevant Year t-1")</i>
ARR_{t-1}	<i>Të hyrat e relizuara të rregulluara në vitin relevant t-1 ("the Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")</i>
I_t	<i>Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurta mbi normën e EURIBOR-it ("the interest rate for the Relevant Year t calculated</i>

based on EURIBOR plus S%, where S is a value to be determined by the Regulator at Periodic Reviews and which reflects the premium payable by the licensee for short-term loans above the EURIBOR rate”)

SHTOJCA 2 VLERAT HYRËSE

- 1 Në këtë shtojcë përshkruhen vlerat hyrëse që janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të OSSH-së.
- 2 Vlerat pasuese specifikohen si vlera fikse të përcaktuara në shqyrtimin periodik, të cilat do të aplikohen gjatë viteve relevante deri në shqyrtimin e vlerave hyrëse.
- 3 Vlerat hyrëse përbëhen nga:
 - 3.1 Jetëgjatësia e aseteve;
 - 3.2 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit;
 - 3.3 Niveli i lejuar i humbjeve;
 - 3.4 Faktori i ndarjes së humbjeve;
 - 3.5 Faktori i efikasitetit;
 - 3.6 Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit ; dhe
 - 3.7 Ndonjë parametër tjetër hyrës që rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.

SHTOJCA 3 BAZA E ASETEVE TË RREGULLUARA

- 1 Në këtë shtojcë përshkruhet përcaktimi i bazës së asetëve të rregulluara me qëllim të llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar (Neni 10) si dhe kthimit të lejuar në kapital (Neni 11).
- 2 Baza e asetëve të rregulluara do të jetë vlerë e rregulluar e shumës së asetëve fikse të përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes. Baza e asetëve të rregulluara do të ndahet në kategoritë e ndryshme të asetëve.
- 3 Rregullatori ka definuar vlerën fillestare të bazës së rregulluar të asetëve (më 1 prill 2012) para fillimit të periudhës së parë rregullative.
- 4 Baza e asetëve të rregulluara do të azhurnohet në çdo shqyrtim periodik apo gjatë përshtatjeve të rregullta si më poshtë:
 - 4.1 Kostoja e lejuar e zhvlerësimit gjatë periudhës rregullative të tanishme do të zbritet nga baza e asetëve të rregulluara dhe do të llogaritet në mënyrë lineare duke përdorur jetëgjatësitë ekonomike apo teknike të asetëve varësisht sipas përcaktimit nga rregullatori;
 - 4.2 Politikat e zhvlerësimit të përcaktuara nga ZRRE lidhur me jetëgjatësinë e asetëve do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente dhe nuk duhet të ndryshohet nga i licencuari për qëllime rregullative;
 - 4.3 Shitjet apo tjetërësimet e asetëve gjatë periudhës rregullative do të zbriten nga baza e asetëve të rregulluara bazuar në vlerën e shitjes së tyre;
 - 4.4 Baza e Asetëve të Rregulluara nuk do të përfshijë asetet e financuara nga grantet dhe kontributet e konsumatorëve (përveç asetëve të përfshira në Bazën e Asetëve të Rregulluara deri në prill të vitit 2012);
 - 4.5 Shpenzimet e lejuara kapitale gjatë periudhës rregullative do t'i shtohen bazës së asetëve të rregulluara nga data kur asetë vihet në shërbim dhe në koston e lejuar në planin e aprovuar të investimeve. Interesi gjatë ndërtimit do të kapitalizohet. Gjatë shqyrtimeve periodike i licencuari mund të kërkojë që kostoja e realizuar e investimit dhe jo e lejuara t'i shtohet bazës së asetëve të rregulluara. Rregullatori duhet ta pranojë kërkesën nëse i licencuari mund ta demonstrojë në mënyrë të qartë që ndryshimi në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara është si pasojë e faktorëve jashtë kontrollit të të licencuarit dhe që ai i ka bërë përpjekjet më të mëdha për të minimizuar rritjet e kostove. Rregullatori do të marrë parasysh kostot e arsyeshme të realizuara dhe krahasimet me kostot e sistemeve të ngjashme krahasuese në Shqyrtimet e ardhshme periodike si masë për parashikimin e kostos së investimeve të ardhshme;
 - 4.6 Nëse një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit nuk vihet në shërbim gjatë periudhës rregullative në fjalë, kostoja e tij e aprovuar nuk i shtohet bazës së asetëve të rregulluara në shqyrtimin pasues periodik, dhe të gjitha të hyrat e përfituara nga

projekti në periudhën e tanishme rregullative do të zbriten nga të hyrat në periudhën e ardhshme rregullative;

- 4.7 Në rastin kur kostoja e mirëmbajtjes është apo ka qenë më herët e përfshirë në kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes, nuk do të kapitalizohet dhe as nuk do të përfshihet në bazën e aseteve të rregulluara; dhe
 - 4.8 Baza e aseteve të rregulluara do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin përgjatë periudhës së mëhershme rregullative apo mund të indeksohen direkt kostot e zhvlerësimit dhe kthimit në kapital në vend të Bazës së aseteve të rregulluara, duke përdorur indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në eurozonë, të publikuar nga Eurostat si masë relevante.
- 5 Jetëgjatësia ekonomike e aseteve për kategori të ndryshme do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në bazën e aseteve të rregulluara. Jetëgjatësia ekonomike do të përcaktohet gjatë shqyrtimeve periodike ashtu që ajo të reflektojë jetëgjatësinë teknike të aseteve, përveç në rastet kur ekziston arsye e dëshmuar se përse jetëgjatësia teknike e asetit duhet të jetë e ndryshme nga jetëgjatësia ekonomike e asetit.
- 6 Investimet kapitale të lejuara do të përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike bazuar në planin e aprovuar të investimit për shqyrtimin e ardhshëm periodik. Plani i aprovuar i investimit do të:
- 6.1 Përfshijë projektet kapitale të cilat janë të nevojshme për të ofruar shërbimet e sistemit të shpërndarjes;
 - 6.2 Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
 - 6.3 Tregoj përfitim të performancës së rrjetit nga çdo projekt kapital, duke iu referuar, në rastet kur është e nevojshme, përmbushjes së ndonjë standardi përkatës të sigurisë së sistemit të shpërndarjes, të sigurisë së operimit apo planifikimit, siç mund të kërkohet nga licenca e OSSH-së;
 - 6.4 Ketë parasysh planet tjera të investimit apo zhvillimore të OSSH-së që janë aprovuar nga rregullatori (dhe çdo ndryshim në mes të këtyre planeve duhet të identifikohet nga OSSH dhe të sqarohet), duke përfshirë këtu planin 5-vjeçar të investimit të përgatitur nga OSSH në pajtim me licencën e aprovuar nga rregullatori; dhe
 - 6.5 Zhvillohet duke përdorur analiza të kostove të diskontuara dhe përfitimeve të projektit kapital.
- 7 Plani i aprovuar i investimit do të implementohet si më poshtë:
- 7.1 OSSH do të bëjë përpjekjet e arsyeshme për të siguruar implementimin e planit të aprovuar të investimit sipas orarit të saj të aprovuar;
 - 7.2 Nëse OSSH, dështon në implementimin e projekteve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në planin e aprovuar të investimit, atëherë OSSH duhet ta njoftojë rregullatorin. OSSH duhet të japë arsye të detajuara për vonesën si dhe orarin e rishikuar;

- 7.3 OSSH mund të aplikojë në çdo kohë te rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me ndonjë projekt tjetër kapital në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet bazës së aseteve të rregulluara në shqyrtimin periodik të ardhshëm; dhe
- 7.4 Nëse OSSH e zëvendëson një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me një projekt alternativ para se të marrë aprovimin e rregullatorit, rregullatori do ta marrë në konsideratë nëse do ta aprovojë ose jo zëvendësimin në shqyrtimin periodik pasues por nuk është i obliguar ta bëjë këtë.

SHTOJCA 4 MESATARJA E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT

- 1 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit do të llogaritet mbi bazë para-tatimore sipas formulës:

$$WACC = (1 - g) * (rE) / (1 - t) + g * (rD)$$

Ku janë:

WACC	Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit ("the Weighted Average Cost of Capital")
g	Gearing (norma borxh:ekuitet) për ("gearing (debt:debt+equity ratio)")
rE	Kostoja reale e ekuitetit (shprehur si %) për ("real cost of equity (expressed as a %)")
rD	Kostoja reale e borxhit (shprehur si %) për ("real cost debt (expressed as a %)")
t	Norma e tatimit mbi korporatat në Kosovë ("Kosovo corporate income tax rate")

- 2 Leverazhi (gearing - g) do të jetë vlera që propozohet nga i licencuari për OSSH dhe përcaktohet nga rregullatori në mes të 0 dhe 1 dhe përfaqëson pjesëmarrjen e borxhit në financimin e përgjithshëm. Kjo vlerë do të përcaktohet mbi bazë të një shqyrtimi të balancuar të përbërjes së financimit të tanishëm të OSSH-së dhe përbërjes së financimit që do të mund të pritej të jetë i arritshëm tani dhe në të ardhmen, duke marrë parasysh përbërjen e financimit të kompanive të ngjashme ndërkombëtarisht.

- 3 Kostoja e ekuitetit (rE) do të jetë vlera që propozohet nga i licencuari për OSSH dhe përcaktohet nga rregullatori duke marrë parasysh ngjashmerinë me kompanitë me fushëveprim të ngjashëm vendor dhe ndërkombëtar si dhe llogaritet duke përdorur modelin për vënien e çmimeve të aseteve kapitale (CAPM - Capital Asset Pricing Model) me formulën në vijim:

$$rE_i = r_f + \beta_i * ERP_m$$

Ku janë:

r _f	është norma pa risk ("risk-free rate")
ERP _m	është premia për riskun në ekuitet ("equity risk premium")
β _i	kovarianca në mes të kthimeve të asetit të ekuitetit në fjalë dhe të aseteve të tërë tregut (beta e ekuitetit)(" covariance between the returns on the individual equity asset and those of the market as a whole (the equity beta)")

- 3.1 Norma pa risk (rf) paraqet koston e borxhit jokoncesionar shtetëror në Kosovë, në terma realë, dhe do të propozohet nga i licencuari për OSSH dhe përcaktohet nga rregullatori duke përdorur të dhëna për koston e borxhit jokoncesionar shtetëror në Kosovë dhe/ose, rast të të dhënave të munguara apo të pamjaftueshme, koston e borxhit jokoncesionar shtetëror të shteteve të cilat kanë status të njëjtë kreditor me Kosovën.
 - 3.2 Premia e riskut mbi ekuitetin (ERPm) propozohet nga i licencuari për OSSH dhe përcaktohet nga rregullatori, duke përdorur të dhëna nga premia e riskut mbi ekuitetin në arenën ndërkombëtare.
 - 3.3 Beta (β) do të propozohet nga i licencuari për OSSH dhe do të përcaktohet nga rregullatori duke përdorur të dhëna mbi betat e aplikueshme në kompani të ngjashme në arenën ndërkombëtare.
- 4 Kostoja e borxhit (rD) do të jetë mesatarja e normës së interesit për kreditë ekzistuese afatgjata (që kalojnë 1 vit) për OSSH-në, shprehur në terma realë dhe e ponderuar sipas vlerës në euro të secilës kredi.
- 4.1 OSSH obligohet të prokurojë hua komerciale (jokoncesionare) përmes një procesi të konkurrencës ose t'ia demonstrojë Rregullatorit se norma e interesit për huatë e marra pa proces konkurrues është e barabartë me, ose më e ulët se, norma e interesit që mbizotëron në treg në kohën kur është nënshkruar marrëveshja e huasë.
 - 4.2 Në rastin kur rregullatori konsideron se norma e interesit për një hua të marrë në mënyrë jokonkurrese e tejkalon normën e interesit që mbizotëron në treg, atëherë diferenca e huas mbi normën e interesit në treg do të përshtatet dhe do të përjashtohet nga llogaritja e koston së borxhit.
 - 4.3 Në rastin kur rregullatori konsideron se ekzistojnë hua të pamjaftueshme prezente për të arritur në një vlerësim të arsyeshëm të koston së huamarrjes për OSSH-në, rregullatori mund të bëjë një përshtatje të koston së borxhit që llogaritet si më lart. Kjo përshtatje do të bazohet në:
 - (i) Vlerësimin e normës së interesit mbizotëruese në treg për huatë e bizneseve të e madhësisë, rrezikut dhe statusit kreditor të ngjashëm me OSSH-në.
 - (ii) Vlerësimin e normës së parashikuar të interesit për huatë e ardhshme koncesionare të OSSH-së.
 - (iii) Vlerësimin e përbërjes së parashikuar të huave komerciale (jokoncesionare) dhe koncesionare në borxhin e OSSH-së për periudhën e ardhshme rregullative.

SHTOJCA 5 SHËRBIMET E PËRJASHTUARA

- 1 OSSH mund të aplikojë një ngarkesë për kryerjen e shërbimeve të përjashtuara, të cilat mund të përfshijnë, (por të kufizohen në):
 - 1.1 Kryerjen e punëve, kostoja e të cilave do të riimburohet nga një përdorues i sistemit apo ndonjë palë e tretë (duke përfshirë këtu çdo punë përforcuese apo punë diversioni) për qëllim të kyçjes së një përdoruesi në sistemin e shpërndarjes (por vetëm deri në atë masë ku shërbimi nuk paguhet në kuadër të ngarkesave për shfrytëzim të sistemit që përshkruhen në këtë rregull);
 - 1.2 Rivendosja e linjave elektrike apo centraleve elektrike (duke përfshirë këtu edhe punët e ndërlidhura me to) në pajtim me ndonjë obligim statutor tjetër nga ai me të cilin obligohet me Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë apo Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.3 Zhvendosjen e linjave elektrike, stabilimenteve elektrike apo pajisjeve matëse që përbëjnë pjesë të sistemit të shpërndarjes për të akomoduar zgjatjen, ridizajnimin apo rihvillimin e objektit në të cilin ndodhet aseti në fjalë ose në të cilin është i kyçur aseti, kostoja e të cilit do të bartet nga përdoruesi i sistemit apo pala që e kërkon zhvendosjen;
 - 1.4 Kryerjen e punëve të linjave elektrike apo stabilimenteve energjetike nëse kërkohet nga një përdorues i sistemit të shpërndarjes për të ofruar shkallë më të lartë sigurie se sa parashihet në licencën e OSSH-së (Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes);
 - 1.5 Kryerjen e shërbimeve tjera që nuk paguhet në kuadër të ndonjë ngarkese tjetër në lidhje me shërbimet e përjashtuara; dhe
 - 1.6 Çfarëdo e hyre tjetër e parregulluar (të hyrat nga dhënia me qira e aseteve, të hyrat nga operatorët e ndryshëm ekonomik, shitja e aseteve, shërbimet e ndryshme ndaj konsumatorëve, etj).
- 2 Taksat për këto shërbime të përjashtuara duhen të caktohen në atë shkallë që do t'i mundësojë OSSH-së të mbulojë:
 - 2.1 Kostot e arsyeshme që kanë dalë gjatë kryerjes së shërbimit; dhe
 - 2.2 Normën e arsyeshme të kthimit në shpenzimet kapitale që përfaqësohen nga shpenzimet e shkaktuara nga OSSH gjatë periudhës para se të merret pagesa e cilësdo shumë që duhet të paguhet nga personi për të cilin është duke u kryer shërbimi në fjalë.
- 3 Në rastet kur është e aplikueshme, këto ngarkesa duhet të përcaktohen në pajtim me metodologjinë e aprovuar të taksave për kyçje.

- 4 Me dhënien e ofertës personit që aplikon për kryerjen e shërbimit të përjashtuar, OSSH duhet të ofrojë detaje për koston siç mund të kërkojë aplikuesi në mënyrë që të përcaktohet nëse ngarkesa është e arsyeshme.
- 5 Oferta duhet t'i referohet rolit të rregullatorit siç parashihet në Ligjin për rregullatorin e energjisë.
- 6 Pas përfundimit të çdo viti relevant, OSSH-ja do t'i ofrojë rregullatorit detaje të shërbimeve të ofruara në kuadër të aktivitetit të shpërndarjes të cilat janë trajtuar si shërbime të përjashtuara nga OSSH gjatë vitit relevant si dhe të deklarojë të hyrat që merren nga këto shërbime.
- 7 Në rastin kur rregullatori mendon se, në bazë të parimeve të përcaktuara në paragrafët e mësipërm, ndonjë shërbim i trajtuar nga OSSH si shërbim i përjashtuar nuk duhet të trajtohet si i tillë, atëherë rregullatori duhet të nxjerrë udhëzime në atë drejtim që shërbimi në fjalë nuk do të konsiderohet si shërbim i përjashtuar që nga data e nxjerrjes së këtij udhëzimi apo nga ndonjë datë tjetër që mund të specifikohet në udhëzim.

SHTOJCA 6 PROCESI I SHQYRTIMIT PERIODIK

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, rregullatori do të publikojë në ueb-faqen zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet e tjera relevante të pranuar nga OSSH apo palët e tjera të interesit, që kanë të bëjnë me shqyrtimin periodik brenda një afati të arsyeshëm. Pas pranimit të tyre dhe Rregullatori do t'i bëjë publike të gjitha të dhënat materiale të dorëzuara nga OSSH, duke mos përfshirë këtu informatat që rregullatori i konsideron komercialisht konfidenciale.
- 2 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin periodik jo më vonë se 120 ditë pune para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative.
- 3 Orari për procesin e gjithëmbarshtëm të shqyrtimit do të dërgohet tek OSSH-ja gjatë inicimit të procesit të shqyrtimit.
- 4 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin periodik duke njoftuar OSSH-në lidhur me:
 - 4.1 Të dhënat për vitet aktuale dhe të parashikuara që kërkohen;
 - 4.2 Formatin në të cilin këto të dhëna kërkohet të dorëzohen;
 - 4.3 Orarin për dorëzimin e propozimit nga OSSH për të hyrat e lejuara maksimale për shqyrtimin e ardhshëm periodik.
- 5 Propozimi i OSSH-së do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
 - 5.1 Të hyrat aktuale të rregulluara të mbledhura gjatë periudhës së tanishme rregullative (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
 - 5.2 Koston e realizuar për ofrimin e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes gjatë periudhës së tanishme rregullative, në linjë me përkufizimin e kostos që është përdorur për llogaritjen e të hyrave maksimale të lejuara;
 - 5.3 Raportin auditorit dhe pasqyrat financiare të audituara për çdo vit fiskal që ka përfunduar në periudhën e tanishme rregullative kurdo që këto janë në dispozicion në pajtim me kërkesat e raportimit të dhëna në Licencën e OSSH-së;
 - 5.4 Vlerën e realizuar të kërkesës maksimale të sistemit të shpërndarjes, volumin e energjisë të shpërndarë dhe numrin e konsumatorëve gjatë periudhës së tanishme rregullative;
 - 5.5 Vlerat e parashikuara të kërkesës maksimale të sistemit të shpërndarjes, volumin e energjisë e të shpërndarë dhe numrin e konsumatorëve për periudhën e ardhshme rregullative;
 - 5.6 Vlerën e realizuar të humbjeve në shpërndarje gjatë periudhës së tanishme rregullative dhe parashikimin për humbjet në shpërndarje për periudhën e ardhshme rregullative;

- 5.7 Propozimin për mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit që do të aplikohet në parashikimin e të hyrave të lejuara maksimale për periudhën e ardhshme rregullative;
 - 5.8 Vlerën e parashikuar të të hyrave maksimale të lejuara, duke raportuar ndaras secilin prej komponentëve të kostos së lejuar për periudhën e ardhshme rregullative;
 - 5.9 Çdo studim të OSSH-së që mund të ketë ndonjë relevancë me çështjet e ngritura në propozimin e OSSH-së;
 - 5.10 Çdo material tjetër që rregullatori konsideron se duhet të përfshihet në propozimin e OSSH-së, me kusht që rregullatori ta ketë njoftuar OSSH-në me kohë të arsyeshme para kalimit të afatit të dorëzimit të propozimit të OSSH-së.
- 6 Gjatë përgatitjes së propozimit të saj, OSSH do të aplikojë parimet dhe formulat e paraqitura në këtë rregull.
 - 7 Në rastin kur OSSH nuk ka aplikuar parimet dhe formulat sipas kësaj rregulle, OSSH duhet të deklarojë të gjitha vendet ku nuk i ka aplikuar ato, arsyet për mosaplikimin e tyre, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit nga përdorimi i qasjes alternative.
 - 8 Ky propozim duhet të përdorë të dhënat më të fundit në dispozicion për çmimin referent të tregut i cili do të aplikohen në llogaritjen e nivelit të lejuar të kostos së humbjeve.
 - 9 Pas marrjes së propozimit të OSSH-së, rregullatori do të vlerësojë saktësinë, relevancën dhe arsyeshmërinë e saj, duke aplikuar metodologjinë e kësaj rregulle, duke përfshirë këtu vlerësimin se a reflektojnë të hyrat kostot e arsyeshme për ofrimin e shërbimeve të OSSH-së.
 - 10 Rregullatori do të përgatisë një vlerësim të përkohshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce) për propozimin e OSSH-së para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative, pas konsultimit me OSSH-në. Vlerësimi i përkohshëm do të paraqesë propozimet e rregullatorit për të hyrat që do të mbulojnë nga OSSH gjatë periudhës rregullative si dhe arsyetimin për këtë propozim. Rregullatori, gjatë përgatitjes së vlerësimit të përkohshëm, mund të amendamentojë, të ndryshojë apo fshijë cilëndo pjesë të propozimit të OSSH-së sipas vlerësimit të tij me kusht që rregullatori të ofrojë t'i identifikojë këto amendamente, zhvendosje apo fshirje dhe të japë arsyetimin për to.
 - 11 Pas përcaktimit të vlerësimit të përkohshëm, rregullatori do të njoftojë OSSH-në dhe do të fillojë procesin e konsultimit publik mbi vlerësimin e tij të përkohshëm në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
 - 12 Pas përfundimit të konsultimit publik, brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce) para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative, rregullatori do të marrë vendimin final për të hyrat për periudhën e ardhshme rregullative. Vendimi i rregullatorit do të jetë në pajtueshmëri me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale të dhëna në vendimin final të rregullatorit do të aplikohen nga data e fillimit të periudhës së ardhshme rregullative.
 - 13 OSSH mund të apelojë apo kontestojë cilindo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 7 PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA

- 1 OSSH do të dorëzojë te rregullatori propozimin për të hyrat e lejuara maksimale për vitin e ardhshëm relevant së paku 50 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. OSSH po ashtu do të përfshijë në këtë propozim të gjitha dokumentet dhe dëshmitë relevante duke përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me të gjithë komponentët e formulave të përshtatjeve të rregullta të dhëna në Shtojcën 1 si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga rregullatori.
- 2 Rregullatori mund të kërkojë nga OSSH që të japë sqarime shtesë për metodën e llogaritjes së propozimit për të hyrat e lejuara maksimale dhe, në këto raste, OSSH do të ofrojë , të gjitha informatat apo shpjegimet sipas afatit kohor që kërkohet nga rregullatori.
- 3 Rregullatori do ta informojë OSSH-në së paku 40 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant nëse e aprovon ose jo llogaritjen nga OSSH të të hyrave të lejuara maksimale të propozuara.
- 4 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale, atëherë këto do të jenë të hyrat e lejuara maksimale për vitin e ardhshëm relevant.
- 5 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale, rregullatori do të japë arsyet dhe dëshmitë për këtë, në pajtim me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale nuk do të përshtaten derisa rregullatori të aprovojë një propozim ose të ofrojë llogaritjen e tij për të hyrat maksimale të lejuara.
- 6 Çdo ndryshim në të hyra, që mund të rezultojë nga llogaritja e gabuar e të hyrave të lejuara, raportimi i gabuar i të hyrave rregullative të realizuara apo kontestimet lidhur me përshtatjen e rregullt, do të mbulohen në vitet relevante pasuese.
- 7 OSSH do të llogarisë dhe do të publikojë rezultatet rreth tarifave SHSSH së paku 15 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant.
- 8 OSSH-ja mund të apelojë apo kontestojë cilindo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 8 PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

- 1 Nëse ka ndodhur një ngjarje e jashtëzakonshme, OSSH-ja mund të kërkojë shqyrtim të jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda (gjashtë muajsh) të shqyrtimit periodik apo para përfundimit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm të mëhershëm.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një ngjarje të jashtëzakonshme. Në këto raste kjo shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre ngjarjeve.
- 4 Brenda 20 ditëve të punës pas kërkesës së OSSH-së për shqyrtim të jashtëzakonshëm, OSSH duhet të dorëzojë raportin për ndikimin financiar, i cili do të përfshijë çështjet në vijim:
 - 4.1 Përshkrimin e ngjarjes së jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm;
 - 4.2 Një përmbledhje të ndikimit të ngjarjes së jashtëzakonshme në biznesin e OSSH-së;
 - 4.3 Vlerësimin e ndryshimit në kostot e OSSH-së në secilin vit nga data kur ka ndodhur apo ka filluar ngjarja e jashtëzakonshme deri në fundin e periudhës së tanishme rregullative;
 - 4.4 Vlerësimin e ndryshimit në të hyrat e parashikuara që rezultojnë nga ngjarja e jashtëzakonshme në secilin vit kur ka ndodhur apo ka filluar ngjarja e jashtëzakonshme deri në përfundim të periudhës së tanishme rregullative;
 - 4.5 Llogartijen për ndikimin financiar në OSSH nga ngjarja e jashtëzakonshme në secilin vit, që llogaritet si shuma e ndryshimeve në kostot dhe të hyrat e OSSH-së. Të hyrat do të trajtohen si numër pozitiv dhe kostot do të trajtohen si numra negativë; dhe
 - 4.6 Llogartijen nëse ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se pragu i materialitetit, shumëzuar me të hyrat që ka marrë OSSH (në vitin para ngjarjes së jashtëzakonshme), shumëzuar me numrin e viteve në mes të datës së ngjarjes së jashtëzakonshme dhe fundit të periudhës rregullative.
- 5 Nëse OSSH vlerëson se ndikimi financiar është më i lartë se pragu i materialitetit, OSSH duhet të përfshijë në raportin e ndikimit financiar propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale. Propozimi për përshtatjen e jashtëzakonshme duhet t'u përmbahet kushteve në vijim:
 - 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë të hyrat e lejuara maksimale në atë mënyrë që vlera neto e tanishme e ndryshimeve të parashikuara të jetë e barabartë me vlerën neto të tanishme të ndikimit financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme duke përdorur mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit si normë të diskontimit;

- 5.2 Koha dhe struktura e përshtatjes së jashtëzakonshme do të shmangë, ku është e mundur, rritjet e menjëhershme të tarifave tek konsumatorët (për shembull duke zbutur ndikimin e përshtatjes së jashtëzakonshme brenda disa viteve).
- 6 Rregullatori gjithashtu mund të fillojë shqyrtim të jashtëzakonshëm pa kërkesën e OSSH-së. Në këto raste, rregullatori do ta njoftojë OSSH-në dhe do të përfshijë një përshkrim të ngjarjes së jashtëzakonshme si dhe një përshkrim të ndikimit të parashikuar. Pastaj, OSSH do të përgatisë raportin për ndikimin financiar sipas procesit të përshkruar më lart.
- 7 Rregullatori mund të kërkojë sqarime shtesë për mënyrën e llogaritjes së raportit për ndikimin financiar si dhe për përshtatjen e jashtëzakonshme dhe, në bazë të kësaj kërkesë, OSSH do t'i dërgojë rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat apo shpjegimet e kërkuara.
- 8 Brenda 20 ditëve pas marrjes së raportit për ndikimin financiar, rregullatori do të njoftojë OSSH-në nëse rregullatori e pranon apo jo propozimin e OSSH-së për përshtatjen e jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse:
- 8.1 I plotëson kushtet e përshkruara më lart në këtë shtojcë;
- 8.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
- 8.3 Merr parasysh të gjitha informatat materiale në dispozicion gjatë asaj kohe.
- 9 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, propozimi për të hyrat e lejuara maksimale do të hyjë në fuqi menjëherë.
- 10 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, rregullatori duhet të ofrojë arsyet dhe dëshmitë për këtë, në pajtim me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale nuk do të përshtaten derisa rregullatori të aprovojë një propozim.
- 11 OSSH mund të apelojë apo kontestojë cilindo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 9 NGJARJA E JASHTËZAKONSHME

- 1 Ngjarje e jashtëzakonshme do të konsiderohet të jetë:
 - 1.1 Çdo ndryshim në shkallën tatimore që aplikohet për OSSH dhe që nuk mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve të rregullta;
 - 1.2 Çfarëdo ngjarje e forcës madhore që përkufizohet në Shtojcën 10;
 - 1.3 Çfarëdo ngjarje tjetër që përmbushë të gjitha kushtet në vijim:
 - (i) Nuk ka qenë nën kontrollin e OSSH-së;
 - (ii) Nuk do të mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve të rregullta; dhe
 - (iii) Ndryshon në masë të konsiderueshme të hyrat dhe/ose kostot e OSSH-së për ndonjë periudhë të caktuar 12 mujore, në atë mënyrë që mund të vlerësohet që mund të tejkalohet pragu i materialitetit (i sqaruar në Shtojcën 8).
- 2 Ndodhja e ngjarjes së jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të filluar shqyrtimin e jashtëzakonshëm por, siç parashihet në Shtojcën 8, ngjarja duhet ta kalojë pragun e materialitetit në mënyrë që të përshtaten të hyrat e lejuara maksimale.

SHTOJCA 10 NGJARJET E FORCËS MADHORE

Forcë madhore - është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm;